

Nr.Regj.62582/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PPËRGJITHSHËM –DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Shafi Nuredin Gashi nga fshati Nagavc, kom. e Rahovecit , për kundërvajtje nga neni 17 ,paragrafi 1.2 lidhur dhur me nenin 7 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 9 ,73, 74 dhe 199 Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 25.10.2013 merr këtë

AKTVENDIM

I PANDEHURI Shafi Nuredin Gashi ,i lindur me 13.02.1972 në fshatin Nagavc, kom. e Rahovecit ,me profesin arkeolog ,t; kryer doktoratur;n për arkeologji, Drejtor i Muzeut të Kosovës,i martuar,prind i tre fëmijve, i gjendjes së mesme ekonomike,i pa dënuar më parë për kundërvajtje,nuk është nën hetime ,me vendbanim në fshatin Nagavc, kom. e Rahovecit .

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse në afatin e paraparë ligjor ,prej 30 ditësh,nga dita e emërimit në postin e Drejtorit të Muzeut të Kosovës ,nuk e ka bër deklarimin e pasurisë, që ka qenë i obliguar sipas Ligjit për Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtarëve te Larte Publikë,nr.04/L-050 .

Me qka ka kryer kundërvajtje e sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1.2,lidhur me nenin 7 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtarëve te Larte Publikë,nr.04/L-050,andaq për këtë e konform neni 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet i shqiptohet

DENIM

Me të holla në shumën prej 300 (treqind euro)€, të cilin denim është i obliguar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky Aktvendim e merr formën e prerë,në favor të KGJK,në xhirrollogarinë rrjedhëse 1000430070000518 e nëse denimin e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë,i njëjti do t'i zëvendësohet me denim burgu në kohëzgjatje prej 15 ditësh,duke llogaritur 20 (njëzet euro)€ për një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka,kurse në emër të paushallit Gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 €,në afat të njëjtë me denimin,në Arkën e kësaj Gjykate

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kunder Korrupsionit, parashtrroi kërkesën me nr.01-4250/12 të dt. 29.12.2012 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër të pandehurit Shafi Nuredin Gashi për kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1.2 e lidhur me neni 7 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtarëve te Larte Publikë,nr.04/L-050.

Gjatë procedurës është marr në pyetje i pandehuri i cili në mbrojtjen e paraqitur para kësaj gjykate i pranon të dhënat në postin e drejtorit të Muzeut të Kosovës ,nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë edhe pse njoftimin për këtë qështje e ka marr përmes postës elektronike ,por deklarimin e pasurisë nuk e ka bërë sepse gjatë tërë verës së vitit 2012 ka qenë i angazhuar me ekipin e tij ,në kërkimet arkeologjike , që kan qenë obligim i autorsisë që rrjedh nga obligimet deri sa ka punuar në institutin e Arkeologjisë .

Pas shqyrtimit të të dhënave ne kërkesë, shiqimit te shkresave te lende,deklaratës së të pandehurit ,shiqimit të Aktvendimit mbi emrimin e të pandehurit në postin e Drejtorit të Muzeut të Kosovës,i datës 12.06.2012 i lëshuar nga Ministria e Kulturës ,Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe provave tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja fitoi bindjen e lirë se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi paragrafi 1.2,lidhur me nenin 7 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtarëve te Larte Publikë,nr.04/L-050 sepse në afatin e paraparë ligjor ,prej 30 ditësh,nga dita e emërimit në postin e Drejtorit të Muzeut të Kosovës ,nuk e ka bër deklarimin e pasurisë, që ka qenë i obliguar sipas Ligjit për Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtarëve te Larte Publikë,nr.04/L-050 ,prandaj duke pas parasysh tëra rrehanat rënduese dhe lehtësuese nën të cilat është kryer kundërvajtje se me kundërvajtjen e tillë nuk janë shkaktuar pasoja të rëndë për shoqërinë dhe se i pandehuri për herë të parë ka ra ndesh me Ligjin , konform neni 9 të Ligjit mbi kundërvajtjet, bëri zbutjen e denimit të përcaktar me Ligjin e cekur si më lartë dhe shqiptoi denimin e cekur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi duke pas parasysh se edhe me këtë denim tek i pandehuri do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe se në të ardhmen nuk do të kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme.


Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi pashallin Gjyqësor është marr në baxë të nenit 109 al.1,pika 6 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrjë parashtruesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh, pasi që të njoftohet me kopjen e këtij Aktvendimi, Gjykatës së Apelit-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i kundërvajtjes ,përmes kësaj Gjykate dhe pa pulla.

VENDOSI GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES

G j y q t a r j a
Salihe Berisha-Ahmetaj



Lipi		
Dipi		
Gjyq	DPK/DM	
Nr. i akt.		
Nr. i masurisë	01	
Nr. i dërgimit		
		03-3606/13
		29.10.2013